



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 97 prot.

Tiranë, më 26. 2. 2021

RELACION


**Lënda: Mbi raportet e monitorimit për 12-mujorin e vitit 2020**

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë për vitin 2020, në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt, sa i përket produkteve të përcaktuara dhe zërave të shpenzimeve. Zbatimi i këtij buxheti është kryer në përputhje me drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe bazuar në parimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore.

Në vijim paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, analiza e përdorimit të fondeve buxhetore për 12-mujorin e vitit 2020, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	66,350	66,050	62,808	95%
Shpenzime kapitale	1,000	1,000	579	58%
<b>TOTALI</b>	<b>67,350</b>	<b>67,050</b>	<b>63,387</b>	<b>94.5%</b>



Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2020, në vlerë 67,350 mijë lekë në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale, janë rishikuar, duke pakësuar shpenzimet operative, me aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.15, datë 15.4.2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin e vitit 2020’ ”, në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, si dhe janë rialokuar me kërkesën e institucionit brenda shpenzimeve korente, duke arritur në vlerën 67,050 mijë lekë.

Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2020 është në nivelin 94.5% ose rreth 1% më e lartë se në vitin 2019, dhe kryesisht kjo rritje vërehet në realizimin e shpenzimeve të personelit.

Buxheti i miratuar për vitin 2020 në shpenzime korente dhe, konkretisht, në shpenzimet e personelit, në analogji dhe me vitet e kaluara, ishte i pamjaftueshëm për plotësimin e detyrimeve ligjore në fushën e pagave për vitin 2020, siç është argumentuar në komunikimet me Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Pamjaftueshmëria e fondeve në shpenzime personeli është paraqitur dhe në detajimin mujor të miratuar në fillim të vitit 2020, ku për muajin dhjetor nuk mbulohet pothuajse fare shpenzimi mujor në paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit e institucionit.

Për sa i përket shpenzimeve të kryera për furnizimin materialo-technik të stafit të institucionit, administrimin e institucionit, krijimin e kushteve optimale për përballimin e situatës së jashtëzakonshme që kishte ky vit, sa i përket mbrojtjes së jetës së punonjësve dhe ndërthurjes së procesit të punës në zyrë me atë *online*, theksojmë se janë kryer konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2020 dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për 12-mujorin e vitit 2020, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve buxhetorë

Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor(plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Realizimi vjetor	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	57,000	60,500	60,397	99,8%
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	9,350	5,550	2,411	43.4%
231	Shpenzime kapitale	1,000	1,000	579	58%
	<b>TOTALI</b>	67,350	67,050	63,387	94.5%

**1. Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”,** buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2020 për këtë zë është 57,000 mijë lekë, buxhet i cili nuk mbulon nevojat e institucionit për të gjithë vitin, parashikuar kjo dhe gjatë hartimit të projektbuxhetit për vitin 2020, si dhe reflektuar në detajimin mujor të buxhetit. Për këtë arsye është kërkuar transferimi i fondeve të lira nga shpenzimet operative në shpenzime për paga, i cili është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në muajin shtator. Buxheti i pagave pas rialokimit ka arritur në vlerën 60,500 mijë lekë.

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është kërkuar, gjithashtu, në muajin nëntor, transferim brenda shpenzimeve korente për të përmbushur detyrimin ligjor për akordimin e shtesës për vështirësi për Njësinë Ligjore, meqenëse buxheti i Institucionit të Komisionerëve Publikë nuk u rishikua me akt normativ gjatë vitit. Megjithëse kishim parashtruar domosdoshmërinë e fondit shtesë për plotësimin e të gjithë nevojave në shpenzime personeli në përputhje me dispozitat ligjore, transferimi i fondeve të lira buxhetore brenda shpenzimeve korente nuk u miratua.

Buxheti i rishikuar i vitit 2020 pas rialokimeve ka mbuluar shpenzimet e personelit për 30 punonjës, mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr.102/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, ‘Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë’ ”, si dhe për 2 punonjësit me kontratë të përkohshme.

Performanca e realizimit të tij për vitin 2020 është në nivelin 99.8%.

**2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”,** buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull, për vitin 2020, është 9,200 mijë lekë dhe arriti në vlerën 5,400 mijë

lekë, pas pakësimit të tij me akt normativ, në muajin prill, në kuadër të pandemisë COVID-19, si dhe pas rialokimit të fondeve me kërkesën e institucionit, nëpërmjet transferimit në fondin e pagave.

Performanca e realizimit të buxhetit në: “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, për vitin 2020, është në nivelin 43.4%. Ky nivel realizimi për vitin 2020, siç do të shpjegojmë në vijim, është kushtëzuar kryesisht nga situata e pandemisë COVID-19.

Institucioni i Komisionerëve Publikë ka rivlerësuar nevojat në shpenzime operative, duke i reduktuar ato në nivelin minimal të shpenzimeve më të domosdoshme për funksionimin e aktivitetit, kryesisht shpenzime për materiale, pajisje dhe shërbime dezinfektimi për kufizimin e përhapjes dhe mbrojtjen nga virusi COVID-19, krahas shpenzimeve të domosdoshme të funksionimit të institucionit.

Gjatë këtij viti janë kryer disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël për shpenzime materiale zyre dhe të përgjithshme, kryesisht materiale pastrimi dhe të mbrojtjes personale, shërbim dezinfektimi, licencimi i *firewall*-it, kancelari, tonera dhe *drum*-e për fotokopjet etj., si dhe me procedura të thjeshtuara: blerje materiale dhe shërbime speciale, si: ujë të pijshëm për punonjësit, blerje dokumentacioni specifik, karburant, mirëmbajtje automjeti, siguracion automjeti, abonimet në shtypin e ditës, larje automjeti etj. Janë lidhur kontratat dhe kryer shpenzime për shërbimin e parkimit, telefoninë celulare etj.

Mosrealizimi i fondeve në këtë zë të shpenzimeve lidhet kryesisht faktin që disa materiale, si letër, tonera etj., mbetën gjendje në magazinë dhe konsumi i tyre ishte më i ulët për shkak të ndërthurjes së punës në distancë me atë në zyrë dhe situatës së krijuar, siç u përmend më lart. Ndërkohë, një pjesë e shpenzimeve të planifikuara, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të realizoheshin në kushtet e kufizimit të lëvizjeve për shkak të pandemisë, si shpenzime udhëtimi e dieta dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.

Për pasojë janë krijuar fonde të lira në artikullin 602, “Shpenzime operative”, të cilat, nëpërmjet transferimit, u kaluan në shpenzime personeli, për të plotësuar nevojat në këtë artikull, sikurse u argumentua më lart.

Analitikisht, shpenzimet operative janë realizuar si më poshtë:

Në mijë lekë			
Nr.	Emërtimi	602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	1,740	576
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	1,870	1,502
3	Shpenzime transporti + udhëtimi	850	164
4	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	660	108
5	Shpenzime të tjera speciale	280	21
	<b>TOTALI</b>	<b>5,400</b>	<b>2,371</b>

**3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”,** buxheti i miratuar për këtë artikull, për vitin 2020, është 1,000 mijë lekë. Gjatë vitit nuk ka pasur rishikime të tij, megjithëse institucioni në komunikimet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë paraqiti gatishmërinë për pakësimin e këtij fondi, për t’u përdorur nga shteti në kuadër të pandemisë. Duke rivlerësuar nevojat janë plotësuar kërkesat në pajisje kompjuterike dhe pajisje të ndryshme.

Performanca e realizimit të buxhetit të artikullit “Shpenzime kapitale”, për vitin 2020, është në nivelin 58%.

Situata e Pandemisë ka pasur ndikimin e vet edhe në realizimin e këtij buxheti. Shpenzimet kapitale administrative janë realizuar duke plotësuar nevojat për barriera mbrojtëse, në vendet e punës së punonjësve, për kufizimin e rrezikut nga virusi COVID-19, si dhe, në mbështetje të punës në distancë, është pajisur Njësia Ligjore dhe dy Drejtoritë e institucionit me pajisje kompjuterike, laptopë.

Në mënyrë analitike, realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2020, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim në tabelë, për çdo projekt investimi.

Në mijë lekë

<b>Investimet</b>	<b>Buxheti vjetor</b>	<b>Buxheti vjetor i rishikuar</b>	<b>Realizimi vjetor</b>	<b>Realizimi në%</b>
Blerje pajisje elektronike	550	550	460	83.6%
Blerje pajisje dhe mobilie zyre	450	450	119	26.4%
<b>TOTALI</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>579</b>	<b>58%</b>

Siç theksuam dhe më lart, buxheti i vitit 2020 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore, duke respektuar prioritetet e MFE-së për kryerjen e shpenzimeve, dhe duke synuar një performancë në rritje të realizimit të fondeve buxhetore në të gjithë zërat e shpenzimeve.

**Nëpunës Zbatues**  
Adelina Kastrati





**Nëpunës Autorizues**  
Alketa Çeli




**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitet paraardhes Viti 2019	(2) PBA Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 12 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	69,518	77,400	67,350	67,050	67,050	63,387	-3,663	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		69,518.00	77,400	67,350	67,050	67,050	63,387	-3,663	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		69,518	77,400	67,350	67,050	67,050	63,387	-3,663	



Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2021		Data	25.2.2021




**ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë						Kodi i Grupit	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik						Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	(2) PBA Plan 2020	(3) Buxheti Vjetor Viti Plan Fillestar viti korrent 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 12 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5)  Diferenca
600	Paga	58,540	60,200	51,500	54,500	54,500	54,495	-5
601	Sigurime Shoqërore	5,920	6,200	5,500	6,000	6,000	5,902	-98
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,643	10,000	9,200	5,400	5,400	2,371	-3,029
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	60		150	150	150	40	-110
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>68,163</b>	<b>76,400</b>	<b>66,350</b>	<b>66,050</b>	<b>66,050</b>	<b>62,808</b>	<b>-3,242</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,356	1,000	1,000	1,000	1,000	579	-421
232	Transferta Kapitale							0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>1,356</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>579</b>	<b>-421</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,356</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>	<b>579</b>	<b>-421</b>
	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>						<b>0</b>	
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>		<b>69,519</b>	<b>77,400</b>	<b>67,350</b>	<b>67,050</b>	<b>67,050</b>	<b>63,387</b>	<b>-3,663</b>


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Celi
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2021		Data	25.2.2021




**ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treqesve te performances/produkteve te programit"**

Emri i Grupit	Komisionerit Publik	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik	3360

ne 000/leke				I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente			
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia matese	Sasia Faktike (sipas vitit 2019)	Shpenzimet (sipas vitit 2019)	Kosto per Njesi (sipas vitit 2019)	Sasia (sipas planit te vitit 2020)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2020)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit 2020)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit 2020)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit 2020)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit 2020)	Sasia Faktike per 12 mujorin e vitit 2020	Shpenzimet Faktike per 12 mujorin e vitit 2020	Kosto per Njesi per 12 mujorin e vitit 2020		V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
Produkti 1	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	nr. Çeshtjesh	127	68,163	537	130	66,350	510	130	66,050	508	103	62,808	610	14%	19%	20%	.....
Produkti 2	Pajisje komp/mobile/pajisje zyre	sete pune	10	1,356	136	9	1,000	111	9	1,000	111	6	579	97	-29%	-13%	-13%	.....
Totali				69,519	672	139	67,350	621	139	67,050	619	109	63,387	706				0

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	25.2.2021

Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	25.2.2021







ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikave se programit"

Periudha e Raportimit: 8 mujori 2020

Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:							Komente
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik							
*Objektivat e politikës*:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2019	Niveli i planifikuar ne vitin 2020	Niveli i rishikuar per 12 mujorin e vitit 2020	Niveli faktik per 12mujorin e vitit 2020	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."								
	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	127	130	130	103	79%	



Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2021		Data	25.2.2021



**ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"**

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	Realizimi Progrosiv nga fillimi i vitit 2020	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progrosiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	450	2020	2020		450	118	118	118	
M630013	Pajisje kompjuterike	550				550	461	461	461	
<b>TOTALI</b>		<b>1,000</b>			<b>-</b>	<b>1,000</b>	<b>579</b>	<b>579</b>	<b>579</b>	<b>-</b>

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2021		Data	25.2.2021

